



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 5 paragrafi 5.1.7, nenin 6 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 15.09.2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.Arjan Shatri**, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Istog, nga subjekti politik "Lëvizja Vetëvendosje", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Qerim Rexhaj.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Arjan Shatri dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 14.09.2023, nr. 09/1-951/2023, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Qerim Rexhaj, për arsye se ka ndërruar jetë (vdekur).

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati në listën e rirenditur është z.Arjan Shatri.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 15.09.2023

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Kreshnik Radonjqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59 dhe 63 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 15.09.2023, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Pjesëmarrjes së KQZ në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në Konferencën Plenare të Shoqatës Globale të Grave në Organet e Menaxhimit të Zgjedhjeve (TMZ)

- I. Miratohet pjesëmarrja e KQZ-së në mbledhjen e “Asamblesë së Përgjithshme në Konferencën Plenare të Shoqatës Globale të Grave në Organet e Menaxhimit të Zgjedhjeve (TMZ)”, e cila do të mbahet në Pragë, Republika Çeke, më datën 8-9 nëntor 2023.
- II. Pjesëmarrës në takim është z.Kreshnik Radoniqi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 15.09.2023

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59 dhe 63 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 15.09.2023, nxjerr këtë:



VENDIM

Për Miratimin e Pjesëmarrjes së KOZ në Takimin Vjetor të “Rrjetit të Drejtësisë Zgjedhore të Evropës dhe Euroazisë”

- I. Miratohet pjesëmarrja e KQZ-së në takimin vjetor të “Rrjetit të Drejtësisë Zgjedhore të Evropës dhe Euroazisë”, i cili do të mbahet në Paris, Francë, më datën 16-17 tetor 2023 si dhe pjesëmarrja në takim virtual më 19 shtator 2023, për shkëmbimin e njohurive nga tre takimet e mëparshme të Rrjetit.
- II. Pjesëmarrës në takim virtual të datës 19 shtator 2023 janë z.Kreshnik Radoniqi dhe z.Arianit Elshani.
- III. Pjesëmarrës në takim vjetor të datës 16-17 tetor 2023 është z.Kreshnik Radoniqi.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 15.09.2023

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 21 të Rregullores së Punës së KQZ, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datën 15.09.2023, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Zëvendësimit të Anëtarit të KQZ-së në Këshillat e KQZ-së

- I. Anëtari i KQZ-së z.Ibrahim Selmonaj, zëvendësohet në Këshillin për Çështje Ligjore, me kryesuesin e KQZ-së, z.Kreshnik Radoniqi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 15.09.2023

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi

